



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1134, datë 24.12.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT/RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE,
NË BASHKINË TIRANË DHE CAKTIMIN E BASHKISË TIRANË
SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, në Bashkinë Tiranë, në vlerën 1 608 555 182 (një miliard e gjashtëqind e tetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, përkatësisht, për:
 - a) ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.15), në vlerën 313 436 038 (treqind e trembëdhjetë milionë e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
 - b) ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.16), në vlerën 311 425 288 (treqind e njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

- c) ndërtimin e godinës TIP në RSU Nr.1 (Nr.18), në vlerën 311 425 288 (treqind e njëmbëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;
- ç) rikonstruksionin e godinave “Nr.20-21; Nr.22-23”, në RSU Nr.1, në vlerën 456 772 100 (katërqind e pesëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e njëqind) lekë pa TVSH;
- d) ndërtimin e shkollës 9-vjeçare “Dritas”, në vlerën 215 496 468 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit/rikonstruksionit të objekteve arsimore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, i transferohet Bashkisë Tiranë në formën e transfertës së pakushtëzuar, në vlerën 321 711 036 (treqind e njëzet e një milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH dhe përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit.
3. Caktimin e Bashkisë Tiranë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit /rikonstruksionit të objekteve arsimore, sipas pikës 1, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

MINISTRI I SHITETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6705/1
DATË 31.12 2020

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

